



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

<b>Datë :</b>	<b>03.06.2016</b>
<b>Referencë</b>	<b>11-344/5</b>
<b>Për :</b>	<b>Kryetar i Komunes-z. Imri Ahmeti</b>
<b>Përmes :</b>	<b>Drejtpërsëdrejti</b>
<b>Nga :</b>	<b>Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Rrustemi</b>
<b>Lënda :</b>	<b>RAPORTI MUJOR-MAJ</b>

Inspektorët e biznesit gjatë muajit maj kanë punuar intensivisht rreth identifikimit të bizneseve të pa regjistruara MTI, dhe pa pranime teknike të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko, higjienik-sanitarë, janë kontrolluar dyqanet dhe depot ushqimore rreth afatshmërisë së mallit, kushtet e ruajtjes së mallit, faturat e furnizimit me mall dhënien e faturave për shërbimet e ofruara konsumatorëve, çmimet e vendosura në artikuj, kalibrimin e peshoreve. Është mbyllur një biznese për shkak të mos respektimit të urdhëresave të dhëna me procesverbal, janë shqyrtuar dy ankesa të konsumatorëve ku kanë blerë produkte të cilat kanë pasur garancion për rregullimin e tyre ndërsa firma nuk iu është përgjigjur konsumatorëve mirëpo pas inspektimit janë kryer obligimet sipas garancionit të produkteve gjithashtu kemi bërë fletëparaqitje për gjykatë ku gjatë inspektimeve kemi hasur në parregullsi. Agjenda kryesore e inspektorëve ka qenë, është, dhe do të mbetet në vazhdimësi përndjekja e pronarëve të biznesit ndaj evazionit fiskal.

Inspektorët sanitar kanë bërë inspektime të transportuesve të ndryshëm me mall ushqimorë dhe higjienik, ky aksion është organizuar në rr."Ibrahim Rugova" dhe gjatë këtij aksioni në njërin prej transportuesve është gjetur mall me afat të skaduar në vlerë prej 74.78 €, malli i tillë është asgjësuar dhe ndaj subjektit është bërë kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje. Gjatë muajit po ashtu është inspektuar me Inspektor të Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë. Objekt i inspektimit kanë qenë inspektimi i shkollave në aspektin higjieniko-sanitarë. I është dhënë urdhëresë drejtoresve të shkollave që të angazhohen maksimalisht në mbajtjen e higjienës në korridore dhe klasa, e në veçanti në nyjet sanitare.

Një kujdes i veçantë i inspektorëve sanitarë ju kanë dhënë kontrollimit të supermaketeve ushqimore duke i sygjeru dhe urdhërua me procesverbal për kushtet e ruajtjes dhe kujdesit për të gjitha produktet ushqimore në bazë të deklaracionit që posedojnë produktet ushqimore e në veçanti prodhimet e qumështi dhe ato të mishit. Një kujdes i veçantë është kushtuar edhe thertores me të vetmin qellim që të kemi një ushqim sa më cilësor për konsum. Falë angazhimit të tillë nuk kemi pasur ndonjë helmim të mundeshim në komunën tonë.

Inspektorët e ambientit kanë inspektuar në mënyrë të vazhdueshme disa fshatra të ndryshme në baze të kërkesave të qytetarëve, kërkesat kishin të bëjnë me ndotjen e mjedisit nga plehurat, mbeturinat e ndryshme dhe ujerat e zeza. Janë inspektuar bizneset që shfrytëzojnë hapësirën publike dhe janë urdhëruar që të pajisen me lejen për shfrytëzim të kësaj pjese, po ashtu janë ndaluar disa biznese që të mos t'i parkojnë veturat e tyre në hapësirë publike përpara lokaleve.

Janë inspektuar kuzhinat që veprojnë në qytet në lidhje me hedhjen e mbeturinave të lëngëta dhe eshtrave, me ç'rast janë urdhëruar që të pajisen me kontejner të veçanët vetëm për natyrën e këtyre mbeturinave.

Kryesisht në agjentin e inspektorëve të mjedisit ka qenë mbrojtja mjedisore nga ndotësit e pakujdesshëm të cilët mund të vështërsojnë jetën e qytetarëve.

Inspektorët e ndërtimit kanë bërë inspektimin e objekteve afariste dhe banesore të cilat kanë filluar të ndërtohen gjatë këtij muaji. Është ndërpre puna dhe janë larguar punëtorët nga vendpunishtja të një objekti shumëkatësh i cili ka filluar të bëjë mbi ndërtim jashtë projektit në rrugën Shën Flori dhe Skënderbeu, po ashtu pronarët janë urdhëruar që të pajisen me leje ndërtimore për atë pjesë të aneksit ndërtimor.

Është kontrolluar çdo pozicion i punës në të gjitha objektet shumëkatëshe, që janë duke u ndërtuar duke mos i lejuar që ta hedhin betonin në vepër para se të kontrollohet plani i armaturës nga ana e inspektoreve të ndërtimit.

Pothuajse çdo dite gjatë këtij muaji janë kontrolluar dhe janë larguar nga vendpunishtja punëtorët tek disa shtëpi që kane filluar të ndërtohen në lagjen e Akllapit si dhe u janë dërguar fletëparaqitje për gjykatë. Në përgjithësi nuk kemi objekte ndërtimore gjatë këtij muaji që është ndërtuar pa leje ndërtimi. Në këtë mënyrë jemi munduar që ta mbrojmë planin rregullativ në qytetin e Lipjanit, ku edhe është arritur qëllimi.

Inspektorët e trafikut kanë bërë inspektim në bashkëpunim me policin kufitare në Aeroportin Ndërkombëtar Adem Jashari, ku janë bërë disa pika kontrolli në lidhje me auto-taksi të cilët ushtrojnë herë pas here veprimtarin ilegale. Po ashtu në këtë muaj janë inspektuar edhe kompanitë e autobusëve në lidhje me rendin e udhëtimit në disa relacione se mos po hasim ndonjë kompani që nuk po e respekton rendin e udhëtimit.

Janë mbajtur dy takime pune me Ministrin e Infrastrukturës, ku është debatuar në lidhje me implementimin e ligjit për transportin rrugor dhe veshhtësitë të cilat e kemi hasur gjatë zbatimit të këtij ligji si dhe mungesat të cilat janë në këtë ligj.

Inspektori i bujqësisë është dal në teren tek çdo aplikues, për përzgjedhjen e fermerëve të cilët kanë aplikuar për Sera dhe Mjedra të ndarë nga K. Lipjanit, janë hartuar listat e poentimit dhe planin e veprimit në teren.

Është bërë inspektim i tokave Bujqësore ku është filluar të bëhet ndërrimi i destinimit të tyre si rezultat i hedhje së dheut apo zhavorrit. Në agjentin e inspektoreve të bujqësisë është mbrojtja e tokave bujqësore nga ndërtimet e egra të cilat kanë tentuar të ndërtojnë në territorin e komunës sonë. Ky është edhe njeri nga problemet mjaft të mëdha që e preokupon jo vetëm komunën ton por edhe shtetin në përgjithësi.

Informatat më të hollësishme statistikore i kemi paraqitur në tabelën e më poshtme

